



## NJOFTIM PËR MEDIA MBI MBLEDHJEN E AMA-S DATË 04.04.2016

Ditën e hënë, më datë 04 Prill, 2016 u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive në të cilën morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Z.Gentian Sala</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Z.Sami Nezaj</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Z.Gledis Gjipali</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Z.Piro Misha</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zj.Suela Musta</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Z.Zylyftar Bregu</b>	<b>Anëtar</b>

### AMA në përputhje me rendin e ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Emërimin e zj. Monika Stafa në pozicionin Kryetar të Këshillit të Ankesave.
2. Emërimin e z. Urim Bajrami në pozicionin anëtar të Këshillit të Ankesave.
3. Miratimin e rregullores “Për transmetimin pa shpërblim të mesazheve me interes të lartë për publikun”.
4. Miratimin e rregullores “Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit”.
5. Miratimin e Kodit të sjelljes së Antareve të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
6. Mosdhënien e autorizimit shoqërisë “Sabatel” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Sabatel”;
7. Zëvendësimin e licencës dhe zgjerimin e zonës për subjektin person fizik Fatjon Latifi, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Krutja”.
8. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për subjektin person fizik Eduart Feka autorizuar për subjektin privat kabllor “Tv Kuçova”.
9. Dhënien e autorizimit subjektit person fizik Aristir Kërri, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Topojë”.
10. Miratimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria ACN për transferimin e të drejtave që burojnë nga autorizimi lëshuar për subjektin person fizik Klodiana Gjata, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “ECN”.
11. Miratimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti person fizik Bilbil Hajdini për ndryshimin e formës së subjektit tregtar nga person fizik Bilbil Hajdini në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “Arlibon” sh.p.k.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

12. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Gentian Kusta, për përpëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Divjaka”.
13. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tata Junior” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tata Junior”.

**AMA gjithashtu mori në shqyrtim ankimet administrative ndaj sanksioneve më gjobë të vendosura ndaj subjekteve audiovizivë, duke vendosur:**

14. Ndryshimin e sanksionit gjobë nr. 3, datë 26.01.2016 të vendosur nga AMA, ndaj shoqërisë “Digitalb” sh.a., për platformën numerike satelitore “Digitalb” nga 2 000 000 (dymilion) lekë, në 1 000 000 (njëmilion) leke.
15. Shfuqizimin e sanksionit gjobë nr. 1, datë 19.01.2016 të vendosur nga AMA, në masën 2 000 000 (dymilion) lekë, ndaj personit fizik Bilbil Hajdini, autorizuar për subjektin kabllor “TV Fieri”.
16. Ndryshimit e sanksionit gjobë nr. 4, datë 10.02.2016 të vendosur nga AMA, ndaj shoqërisë “Elbasan Cable” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “TV Elbasan Cable”, nga 2 000 000 (dymilion) lekë, në 1 000 000 (njëmilion) lekë.
17. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionin me gjobë nr. 6, datë 10.02.2016 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj personit fizik Dritan Xhaçi, për subjektin kabllor “TV Xhaçi”.
18. Rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të sanksionin me gjobë nr. 5, datë 10.02.2016 të vendosur nga Grupi i Inspektimit, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, ndaj personit fizik Dritan Xhaçi, për subjektin kabllor “TV Xhaçi”.

**Tiranë, 4 Prill 2016**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**